

# **RASTI I NJË DISKRIMINIMI SEGREGIMI TË MUNDSHËM NË KOSOVË ?**

*Jur.Dipl. Besart Elshani  
ODIHR-Intern,  
OSCE RC Prizren*

# I. TË DHËNAT PËR KOMUNITETET ROMË, ASHKALINJË DHE EGJIPTIANË NË KOSOVË

## I.1. SITUATA E KOMUNITETEVE ROMËË, ASHKALINJËNË DHE EGJIPTIANË

- *Komunitetet romë, ashkalinjë dhe egjiptianë përveç problemeve historikisht të trashëguara, në dekadën e fundit në Kosovë kanë qenë para shumë vështirësive dhe sfidave që kanë dal nga konflikti 1998-99, që e ka përkeqësuar gjendjen e tyre edhe më shumë.*
- *Tranzicioni nga lufta i viktimizoi edhe më shumë këto komunitete, të cilat edhe pse janë pjesë aktive e reformave demokratike, vazhdojnë të jenë grupe me nevoja të posaçme, edhe përkundër përparimit të dukshëm të pozitës së tyre në dekadën e fundit.*

# I. TË DHËNAT PËR KOMUNITETET ROMË, ASHKALINJË DHE EGJIPTIANË NË KOSOVË

- *Sot Romët, Ashkanlinjët dhe Egjiptianët , më shumë se kurrë më parë kanë ndërtuar potencial që të kujdesen për vete nëpërmes të shumë organizatave jo-qeveritare, partive politike dhe përfaqësueseve të tyre në Parlament, dhe gëzojnë kuotën e obligueshme të përfaqësimit në këtë institucion.*
- *Por në anën tjetër, përfaqësuesit e këtyre komuniteteve, siç shihet nga ky studim, sot janë në margjinat e zhvillimeve pozitive në Kosovë, ku shquhen me pjesëmarrjen më të vogël në zhvillime ekonomike (punësim), administratë publike, si dhe lëmi tjera siç është edukimi, mediat dhe komunikimi, etj.” –sipas një studimi të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).*

# I. TË DHËNAT PËR KOMUNITETET ROMËË, ASHKALINJËNË DHE EGJIPTIANË NË KOSOVË

## Shpërndarja Gjeografike

Sipas regjistrimit të popullsisë në Kosovë (2011) Komunitetet Romëë, Ashkalinjë dhe Egjiptianë janë më së shumti të përqendruar në:


- Gjakovë - (Romë-738, Ashkalinjë-613, Egjiptianë-5117),
- Fushë Kosovë - (Romë-436, Ashkalinjë-3230, Egjiptianë-282),
- Prizren (Romë-2899, Ashkalinjë-1350, Egjiptianë-168),
- Pejë (Romë-993, Ashkalinjë-143, Egjiptianë-2700) dhe në
- Ferizaj (Romë-204, Ashkalinjë-3629, Egjiptianë-24) - ndërsa në komunat tjera janë më pak të përqendruar.

# I. TË DHËNAT PËR KOMUNITETET ROMËË, ASHKALINJËNË DHE EGJIPTIANË NË KOSOVË

- Përqindja më e madhe e komunitetit Romë jeton në komunën e Prizrenit,
- Komuniteti Ashkalinjë është më i koncentruar në komunën e Fushë Kosovës dhe Ferizajt, ndërsa
- Pjesa dërmuese e komunitetit Egjiptianë jetojnë në Rrafshin e Dukagjinit, gjegjësisht në komunën e Gjakovës dhe Pejës


# NUMRI TOTAL I KOMUNITETEVE ROMË, ASHKALINJËNË DHE EGJIPTIANË NË KOSOVË

■ 8824 Romë ■ 15436 Ashkalinjë ■ 11524 Egjiptianë




## Gjakovë

738 Romë   613 Ashkalinjë   5117 Egjiptianë



## Fushë Kosovë


■ 436 Romë   ■ 3230 Ashkalinjë   ■ 282 Egjiptianë






## Prizren

■ 2899 Romë   ■ 1350 Ashkalinjë   ■ 168 Egjiptianë




## Pejë

■ 993 Romë   ■ 143 Ashkalinjë   ■ 2700 Egjiptianë



## Ferizaj

204 Romë   3629 Ashkalinjë   24 Egjiptianë



# I. TË DHËNAT PËR KOMUNITETET ROMË, ASHKALINJË DHE EGJIPTIANË NË KOSOVË

## ✘ Vendbanimi

Pjesa më e madhe e pjesëtarëve të këtyre tri komuniteteve jetojnë:

- në vendbanime të urbanizuara, (qytete e qyteza) dhe ndërkohë pjesa tjetër jetojnë në fshatra.

Nga të tri komunitetet, komuniteti Egjiptianë ka përqindjen më të madhe të pjesëtarëve të tij që jetojnë më së shumti në zonën rurale, për dallim nga dy komunitetet tjera që kryesisht jetojnë në qytete e qyteza.

# I. TË DHËNAT PËR KOMUNITETET ROMË, ASHKALINJË DHE EGJIPTIANË NË KOSOVË

## Rrethina

Këto komunitete jetojnë kryesisht në vendbanime të cilat janë të banuara me popullatë të përkatësive të ndryshme etnike, në vendbanime që karakterizohen nga popullata e përzier (shqiptarë, serbë, turq, boshnjakë, Romë, Ashkalinjë, Egjiptianë, etj.)

Pjesa më e madhe e këtyre komuniteteve preferon të banojnë në zona me përzierje të lartë etnike. Megjithëse, një numër i konsiderueshëm mbi 26.3% i tyre jetojnë në vendbanime që janë të banuara vetëm nga komuniteti shqiptar. Një numër i vogël i tyre, rreth 2.9%, jetojnë në vendbanime të banuara nga komuniteti serb.

## **II.RASTI I NJË DISKRIMINIMI/SEGREGIMI TË MUNDSHËM NË KOSOVË ?**

## II.I.KORNIZA LIGJORE E KOSOVËS KUNDËR DISKRIMINIMIT

- ✘ Kushtetuta e Kosovës-ratifikuar më 9 Prill 2008 dhe hyri në fuqi më 15 Qershor 2008
- ✘ Ligji Kundër Diskriminimit në Kosovë-Nr.2004/3
- ✘ Ligji për Barazi gjinore në Kosovë-Nr.2004/2
- ✘ Udhëzimi Administrativ Nr.2005/8, mbi përcaktimin e kompetencave dhe përshkrimin e detyrave të Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Komuna

# KUSHTETUTA E KOSOVËS

## KAPUTULLI 2:

*Neni 24.1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim*

*Neni 24.2: Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, preardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*



# LIGJI KUNDËR DISKRIMINIMIT

## Kapitulli 1 (Dispozitat e Përgjithshme)

### *Neni 1*

*Qëllimi: Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritja e shkallës së barazisë efektive dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të personave në Kosovë para Ligjit.*

### Neni 2

#### Parimet

- a. Parimi i trajtimit të barabartë
- b. Parimi i përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave
- c. Parimi i mirëkuptimit të tolerancës ndëretnike të qytetarëve të Kosovës

# LIGJI KUNDËR DISKRIMINIMIT

Neni 3

*Termet-janë pothuajse të njëjta me ato të mbuluara në prezentimet në standardet ndërkombëtare dmth ngacmimet, viktimizimi etj. Megjithatë ka dy terma shtesë:*

1.) Një udhëzim për të diskriminuar kundër një personi bazuar në shkaqe të tilla si përkatësia etnike duhet të konsiderohet si diskriminim,

2.) Segregacioni


# LIGJI KUNDËR DISKRIMINIMIT

Ç'është Segregacioni ?

# LIGJI KUNDËR DISKRIMINIMIT

- ✘ Segregacioni – do të konsiderohet të ketë ndodhur kur:
  - Një person ose më shumë persona janë të ndarë/të veqar nga të tjerët nga ndonjë person/a fizik apo juridik, ose nga një kombinim i personave të tillë, që janë ose nga sektori publik apo privat apo ndoshta nga të dy sektorët,
  - Kur një veqim i tillë është bërë në bazë të kriterëve të tilla si: feja, gjinia, përkatësia etnike, etj.
  - Përveq rasteve kur një ndarje e tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim
  - Me mjetet për arritjen e atij qëllimi janë të nevojshme dhe proporcionale.

**POR ...**



## **II.II. POR KUSH E MORI INICIATIVËN PËR NDALIMIN E SEGREGIMIT NË SHKOLLA ?**

**Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve-ECMI**

Në vitin shkollor 2011-2012, ECMI Kosova ka marrë raporte mbi praninë e klasave të ndara në disa shkolla në komuna të ndryshme në Kosovë, duke përfshirë edhe shkollën fillore “Mustafa Bakija” në Gjakovë.



# ÇKA BËRI ECMI ?

- ✘ ECMI Kosova në bashkëpunim me Qendrën për Ndhmë Juridike dhe Zhvillim Regjional (CLARD) paraqiti ankesa në shkolla përkatëse, duke rezultuar deri në fund të vitit shkollor në ristrukturimin e të gjitha klasave të ndara dhe risistemimin e fëmijëve në klasa multi-etnike.
- ✘ Në Gjakovë, kjo u shoqërua nga një direktivë të lëshuar nga Kryetari i Komunës kundër segregacionit në arsim.
- ✘ Ideja ishte që për zgjidhjen e qëndrueshme të këtij problemi të ishte e nevojshme një politikë formale për të ndaluar segregacionin në arsim
- ✘ MASHT është pyetur për bashkëpunim në këtë drejtim, por ajo ishte e mendimit se qështja tashmë ishte e rregulluar në mënyrë adekuate dhe ishte zgjidhur në mënyrë efektive.

# ÇKA BËRI ECMI ?

- × Në fillim të vitit shkollor 2012-2013, ECMI Kosova ka marrë raporte nga prindërit e komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptianë që në shkollën fillore “Mustafa Bakija” ishte krijuar një klasë e re, në klasë të parë me vetëm nxënës Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptianë
- × Prindërit autorizuar ECMI Kosova për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që kjo praktikë të ndalohet
- × Menjëherë një ankesë është dorëzuar MASHT për të cilën nuk është marrë përgjigje
- × U organizua një vizitë në shkollë për të verifikuar praktikën e segregacionit ku u konfirmua se ka pasur vetëm fëmijë të komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptianë në klasë
- × Shkolla argumentoi kinse pesë fëmijë shqiptarë që vijojnë mësimin në atë klasë mungonin atë ditë
- × Por në ditar emrat e këtyre fëmijëve shqiptarë ishin shënuar me laps, kurse emrat e gjithë fëmijëve të tjerë ishin regjistruar me stilolaps.

## ÇKA BËRI ECMI ?


- ✘ Pastaj, ECMI Kosova në bashkëpunim me CLARD vendosi të mbështesë tetë prindërit e fëmijëve të klasës së ndarë , duke paraqitur një padi kundër Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Gjakovës

# ÇKA BËRI ECMI ?

- ✘ Kjo padi është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë të Mërkurën me 16 Janar 2013 nga përfaqësuesi ligjor i prindërve të kërkojë që:
  - *Klasa e segreguar të shpërbëhet*
  - *Fëmijët të transferohen në një klasë multi-etnike dhe*
  - *Të sigurohet kompensimi për dëmet jo-materiale të pësuar për shkak të shkeljeve të të drejtave të njeriut*

# ÇKA PAS DORËZIMIT TË PADISË NË GJYKATËN THEMELORE NË GJAKOVË ?

Me 26 Shkurt 2013 u mbajtë seanca e parë dëgjimore në gjykatën e qështjes paraprake për rastin e Segregimit në Gjakovë



# RASTI I SEGREGIMIT NË GJYKATË

Përshkrimi nga seanca dëgjimore në gjykatë:

- Gjyqtari tha se kishte ftuar Avokatin e Popullit, por nuk ka pasur asnjë përgjigje dhe ai nuk mori pjesë në këtë seancë
- Bahtir Troshupa, avokati (ECMI) prezentoj rastin dhe provat për seancën dëgjimore. Ai së pari kërkoi që paditësi duhet të lirohet nga pagesa e shpenzimeve procedurale sepse nuk ka mundësi të paguajë. Kjo kërkesë është dhënë nga gjyqtari në fund të seancës.

# RASTI I SEGREGIMIT NË GJYKATË

## ✘ Propozimet

1. Duhet të ketë një hetim / monitorimi të situatës në Mustafa Bakija për të konstatuar faktet nga Inspektoriati i Arsimit
2. Një psikolog i caktuar për të vlerësuar efektin që ka pasur ndarje/segregimi te nxënësit
3. Të caktohet një psikolog në gjykatë si një ekspert dhe të sigurojë dëshmi / një vlerësim i gjendje shpirtërore të nxënësve
4. Një ekspert pedagogjik për të vlerësuar efektin që mund të ketë në rast të largimit të nxënësve nga shkolla



# RASTI I SEGREGIMIT NË GJYKATË

- Vlera e kompensimit që duhet dhënë paditësit duhet të përcaktohet nga ekspertët
- Avokati që përfaqëson Drejtorinë e Arsimit të Gjakovës, tha se klasa e ndarë nuk ishte diskriminim, por rezultat i strukturës së popullatës në shkollën fillore “Mustafa Bakija”
- Drejtoria e Arsimit kishte sjellë një vendim në lidhje me ri-organizimin e shkollave duke sugjeruar që të bashkojë nxënësit e Mustafa Bakija me nxënësit e shkollës Yll Morina për t’u siguruar që klasat të jenë të përziera
- Kështu klasat 1-5 do të vijojnë në Shkollën Fillore “Mustafa Bakija” dhe klasat 6-8 në Yll Morina. Kishte 21 nxënës të regjistruar në shkollën Mustafa Bakija, 16 prej të cilëve janë të komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptianë dhe 5 shqiptarë

# RASTI I SEGREGIMIT NË GJYKATË

- Z.Troshupa kundërshtoi provat e paraqitura nga i pandehuri dhe deklaroi se rasti kundër Drejtorisë së Arsimit duhet të jetë si padi e ngritur në emër të nxënësve të klasës së parë
- Gjqëtari aprovoi kërkesën për heqje dorë nga pagesa procedurale për paditësin
- Gjqëtari pyeti se kush do të paguajë për ekspertët. Z Troshupa përgjigjet duke pohuar se shpenzimet duhen të bëhen nga gjykata, për të cilën gjykatësi u pajtua. Gjkatësi gjithashtu aprovoi kërkesën nga pala paditëse që të kërkojë që gjykata të bëjë hetimin më shumë në këtë qështje. Inspektimi do të kërkohet nga inspektori i arsimit.
- Avokati i të pandehurit nuk kishte njohuri nëse drejtori i arsimit dinte për klasat e ndara (*Gjkatësi e bëri këtë pyetje sepse ishte i interesuar t'a dinte*).

# PYETJE DHE PËRGJEGJE



**Ju Faleminderit !**